



RREGULLORJA E ANKANDIT TË DREJTPËRDREJTË

Definicionet ShAK:

Shtëpia e Ankanëve Kosova Shitësi: Personi i cili shet artikuj nëpërmjet ShAK-ut

Llot/Artikull: Artikulli i ofruar për shitje në ShAK

Numri i llotit: Numri unik i cili i vendoset secilit artikull për shitje për nevoja të identifikimit

Provizioni i Furnitorit: Shuma e pagueshme nga Shitësi ShAK-ut për shitje të Llotit, e llogaritur nga çmimi i çekanit, sipas tarifave në fuqi, plus TVSH

Ofertë: Një sinjal, i pranueshëm për drejtuesin e ankandit, që tregon një shumë të caktuar për një Llot të ofruar

Ofertuesi: Personi i kualifikuar për të marrë pjesë në ankand i cili identifikohet me një numër unik

Blerësi: Ofertuesi i pranueshëm nga drejtuesi, cili jep ofertën më të lartë e cila arrin ose tejkalon çmimin rezervë të përcaktuar nga Shitësi

Çmimi Rezervë: Çmimi minimal për shitjen e një Lloti, i dakorduar në mes të Shitësit dhe ShAK-ut

Çmimi i Çekanit: Oferta më e lartë në momentin që çekani bie, përjashtuar të gjitha provizionet

Çmimi i Blerjes: Çmimi i çekanit plus provizioni i Blerësit, TVSH e aplikueshme, ngarkesat dhe shpenzimet tjera që mund të jenë të aplikueshme sipas Tariforës në fuqi

Provizioni i Blerësit: Shuma e paguar nga Blerësi ShAK-u për blerjen e artikullit; e llogaritur në Çmimin e Çekanit plus të gjitha provizionet dhe shpenzimet e aplikueshme nga Tariforja

Të Ardhurat nga Shitja: Shuma neto e pagueshme Shitësit e që do të jetë; Çmimi i çekanit minus Provizionet e Furnitorit sipas Tariforës në fuqi dhe të gjitha shumat tjera që i takojnë ShAK-ut. Depozitat e ofertave që nuk përfundojnë me shitje (ofertat e dështuara) nuk bëjnë pjesë në Të Ardhurat nga Shitja

Tariforja: Dokumenti që përcaktontarifat, provizionet dhe ngarkesat tjera ngarkuar nga ShAK-u. Të përdoret bashkë me këtë Rregullore. Mund të ndërrohet në çdo kohë dhe pa njoftim paraprak

Vendimet e Drejtuesit të Ankandit Janë Përfundimtare

Të Përgjithshme

- Kjo Rregullore mund të ndërrohet në çdo kohë dhe pa njoftim paraprak. Me hyrjen në fuqi të Rregullores së re shfuqizohen të gjitha Rregulloret e përparshme. Secila rregullore duhet të përmbajë datën e hyrjes në fuqi dhe datën e Rregullores së përparshme që e shfuqizon/zëvendëson.
- Kjo Rregullore është efektive nga data 1 Janar 2020 dhe është Rregullorja e dytë për ankand të drejtpe drejtë.
- Artikujt që shiten nëpërmjet ShAK-ut ofrohen në parimin 'Siq Janë'. Nuk jepet kurfarë garancioni për to. Çdo informatë e dhënë për artikujt e ofruar në shitje duhet të konsiderohet e pa sigurtë dhe e pa saktë.
- Personat mbi moshën 18 vjeçare kanë të drejtë të marrin pjesë në ankand.
- Veturat dhe gjërat personale janë në rrezik të pronarit gjatë kohës që janë në hapësirat e ShAK-ut.
- ShAK-u është përgjegjës për artikujt e ofruar për shitje në lartësinë e vlerës së pritshme të shitur e më së shumeti në çmimin rezervë të caktuar nga Shitësi.
- Shiqimi i artikujve mund të bëhet deri në momentin e fillimit të ankandit. Një fotografi e secilit llot do të shfaqet gjatë ankandit.
- Webfaqja e vetme e ShAK-ut është www.ankandet.com, numri telefonit 045 600050 dhe faqja zyrtare e Facebook-ut është [facebook.com/ankandet](https://www.facebook.com/ankandet).
- ShAK-u ka të drejtë të anulohet ndonjë ankand, të shkurtojë apo të zgjasë kohën e shqimit ose të ndërrojë datën e ankandit në çdo kohë.



- Të gjitha pagesat me kartela bankare mund të kenë një shumë shtesë (referohuni tek Tariforja).
- Te gjithë ofertuesit duhen të regjistrohen paraprakisht, të paraqesin dokument identifikues dhe të paguajnë depozitë nëse kërkohet.
- Ofertat duhen të bëhen qartë nëpërmjet ngritjes së kartelës me numër unik. Sigurohuni që drejtuesi e sheh dhe e kupton se jeni duke ofertuar.
- Ofertat nuk merren parasyshtë pas përfundimit të ankandit.
- Blerësit dhe Shitësit janë përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe implikimet tatimore, të TVSH-së, doganore e të ngjashme që rrjedhin nga shit-blerja nëpërmjet ShAK.
- ShAK-u nuk merr parasyshtë çfarëdo obligimi, taksa apo detyrime/borxhe tjera.
- Të gjitha fotografitë dhe ilustrimet tjera të paraqitura në katalog janë vetëm për orientim dhe nuk duhet të merren për të sakta. - Punëtorët, pronarët, agjentët e ShAK-ut si dhe anëtarët e familjes së tyre nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ankand.

Ankandi i drejtpërdrejtë

- Pjesëmarja në ankand lejohe në diskrecion të plotë të ShAK-ut. ShAK-u mund të kërkojë nga klientët të bëjnë depozitën paraprake dhe mund të vendosë nëse depozita bëhet me para të gatshme apo përmes bankës.
- Në rast se ndonjë artikull kaçmim rezervë, artikulli nuk doshetet më pak se kyçmim. Kyçmim është konfidencial dhe ShAK-u vendos nëse do ta bëjë publik.
- Drejtuesi ka të drejtën të largojë ndonjë person nga salla, të kërkojë që pagesa e plotë të bëhet paraprakisht, të refuzojë ndonjë ofertë, avancojë ofertat sipas vendimit të vet, të tërheqë, të ndajë apo të grupojë artikujt.

Blerësit

- Në rast se Blerësi nuk i përmbush detyrimet e veta pas ofertimit, depozita humbet.
- Blerësi ka parasyshtë se faturat e gjeneruara gjatë ankandit apo menjëherë pas tij mund të kenë gabime dhe mund të rishiqohen/korigjohen.
- Nëse ofertuesi nuk është regjistruar paraprakisht, duhet të furnizojë ShAK-un me: emrin, adresën, detajet e bankës dhe dëshminë e identitetit.
- Nëse ofertuesi është person juridik/kompani duhet të furnizojë ShAK-un me të dhënat e biznesit: Çertifikata e biznesit, certifikatën e numri fiskal dhe informatat e biznesit. Në rast se ofertuesi nuk është pronar i duhet autorizim nga ana e kompanisë.
- Blerësi ka të drejtë të ofertojë vetëm në emër të vet. Në rast se dëshiron të ofertojë në emër të ndonjë personi tjetër, nevojitet autorizim nga ai person.
- Të gjitha pretendimet në lidhje me pronësinë, prezantimin e shtrembëruar e të ngjashme duhet bërë në afat kohor dyjavor pas përfundimit të ankandit.
- Pagesat duhen të bëhen nëpërmjet llogarisë zyrtare të ShAK-ut.
- Blerësit do të i lëshohet fatura në momentin e tërheqjes së artikujve të blerë. Fatura do të përfshijë: emrin dhe mbiemrin e Blerësit, përshkrimin e artikullit të blerë dhe shumën e paguar. Fatura do të vuloset dhe nënshkruhet nga përfaqësuesi i ShAK-ut.
- Pagesat duhet të bëhen brenda 3 ditë pune pas ditës së ankandit në xhirollogarinë zyrtare të ShAK-ut. Luteni të shënoni emrin e Blerësit dhe numrin e llotit në përshkrim të pagesës bankare.
- ShAK-u ka të drejtë të refuzojë blerjen e cilitdo llot në qoftë se të gjitha ofertat nuk respektohen.
- Transporti i artikujve nga ShAK-u është përgjegjësi e Blerësit. Në qoftë se ShAK-u propozon transportues, mjeshër apo ngjashëm, nuk merr përgjegjësi për shërbimet e dhëna.
- Para se të bëhet tërheqja e artikujve të fituar, pagesa e plotë duhet bërë në xhirollogarinë e Klientëve të



ShAK-ut.

- Tërheqja e artikujve duhet të bëhet brenda 3 ditë pune pas ditës së ankandit. Në rast se nuk bëhet kjo, ShAK-u ka të drejtë të aplikojë tarifat e deponimit (shih Tariforen) apo të vendosë artikullin në ankandin e ardhshëm. - ShAK-u dhe të gjithë të punësuarit e tij nuk mbajnë përgjegjësi për çfarëdo dëmtimi apo humbje të artikujve.
- Në rast se Blerësi nuk bën pagesën dhe tërheq artikullin brenda 5 ditë pune pas përfundimit të ankandit, ShAK ka të drejtën të vazhdojë me një nga këto veprime pa e njoftuar më tutje Blerësin:
- Vendosja e artikullit në ankandin e ardhshëm
- Shitja një pjesëmarrësi tjetër, i cili pajtohet të paguaj ofertën më të lartë
- Deponojë artikullin duke aplikuar tarifat e deponimit, sipas Tarifores në fuqi

Pjesëmarrja në ankand të drejtpërdrejtë

- Ofertuesit këshillohen të kontrollojnë artikujt para fillimit të ankandit dhe të sigurohen për gjendjen e tyre paraprakisht. Gjatë kësaj kohe, ofertuesi është i këshilluar t'i bëjë të gjitha pyetjet rreth pronësisë, çështjeve ligjore e të ngjashme.
- Blerësit potencialë këshillohen të marrin pjesë personalisht në ankand. Në rast se nuk kanë mundësi të marrin pjesë, ShAK-u do të ofertojë në vend të tyre pas plotësimit të formës: "Oferta në rast të Mungesës" e cila nënshkruhet dhe i dorëzohet ShAK-ut së paku një ditë para ankandit. Të gjitha informatat nga blerësit/shitësit janë konfidenciale dhe nevojiten vetëm për proceduar të brendshme të kompanisë.

Pjesëmarrja në ankand të drejtpërdrejtë

- ShAK-u ka të drejtën e plotë mbi: pranueshmërinë e Llotit për shitje, datën e ankandit, mënyrën dhe llojin e ankandit, përshkrimin në katalog dhe çdo gjë tjetër që lidhet me shitjen e Llotit në ankand.
- ShAK-u ka të drejtën të tërheq nga shitja, të ndajë apo të grupojë llotet për shitje gjatë ankandit.
- ShAK-u ka të drejtë të anulojë shitjen e artikujve në rast të evidentimit të Parregullësive, mungesën e dokumentacioneve apo pronësisë
- Furnitori ka parasysh dhe pajtohet që ShAK-u mer provizion edhe nga Blerësi.
- Furnitori deklaron se artikujt janë ligjërisht të tyre, të lira nga pengu ose ka të drejtën ligjore të i shesë. - Furnitori ka për detyrë të organizojë transportin e artikujve deri në ShAK.
- Në rast se furnitori dëshiron të vendos Çmim Rezervë në Llot, ShAK-u duhet të njoftohet së paku një ditë para fillimit të ankandit.
- PAGESA E TË ARDHURAVE nga Shitja do të i bëhet Furnitorit brenda tridhjetë ditësh pas ditës së ankandit, neto nga të gjitha shpenzimet dhe provizionet përkatëse.
- Furnitori ka të drejtë të tërheq artikullin e pa shitur pas ankandit të parë, mirëpo aplikohen shpenzimet administrative sipas Tarifores në fuqi.
 - Furnitori nuk ka të drejtë të tërheq artikullin para ankandit të parë, në rast të tërheqjes aplikohen shpenzimet administrative sipas Tarifores në fuqi.
- Artikujt e pa shitur mund të mbesin për ankandin e rradhës mirëpo tarifat e deponimit sipas Tariforës do aplikohen. Në rast se ka çmim rezervë në artikull, ky çmim rezervë do të përgjysmohet në ankandin e dytë. Në rast se artikulli nuk shitet në ankandin e dytë atëherë artikulli shitet pa çmim rezerve.